

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË

“C & S Construction Energy” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “C & S Construction Energy” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 14/07/2008 me administrator Z.Arjan Cukaj, me objekt veprimtarie: Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Rapuni 1" dhe "Rapuni 2" tek autoriteti kontraktues, ku përfshihet financimi, projektimi, ndertimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, në zbatim të kontratës së koncesionit..Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT K81914029T.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti i shoqërisë “C & S Construction Energy” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm rregjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2019 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.



SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI

AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën 1,383,789 leke, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, për sa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën 9,006,603 lekë, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018 10,390,392 lekë

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019 1,383,789 lekë

Diferenca 9,006,603 leke

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 133,344,672 lekë ku përfshihen detyrimet e klientëve, llogaria 411 "Kliente për mallra, produkte e shërbime"

INVENTARI

Inventari për vlerën 12,950 lekë, përfshihet llogaria 311 "Materiale të para"

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 1,256,348,079 lekë, ku përfshihen: llogaria 2182 "Pajisje informative" 537,332 leke, 2134 "Makinëri, pajisje pune" 12,069,768 leke, llogaria 2111 "Toke djerre" 750,000 leke, llogaria 20801 "HEC-i" 1,388,413,407 leke dhe llogaria 2818 "Për të tjera AA materiale" 145,422,428 leke



PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2019 detyrimet në total janë në vlerën **1,187,669,178** lekë që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale **536,322,401** lekë, ku përfshihen:

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, llogaria 401 "Llogari të pagueshme" në vlerën **509,620,559** lekë

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 10,893,938 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 10,376,620 lekë dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" 517,318 lekë.

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën **15,807,905** lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi te ardhurat personale" 38,480 leke, llogaria 444 "Tatim mbi fitimin" 4,132,252 leke, llogaria 4457 "Shteti-TVSH e pagueshme" 11,637,172.74 leke.

Detyrime afatgjata në vlerën **651,346,777** leke ku përfshihet llogaria 455 "Te drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve" dhe llogaria 46806 "Huamarrje nga NBG".

KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën **203,420,312** leke dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për **100,000** lekë, nga Fitimi i Pashpërndarë **182,330,886** lekë dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2019, marrë nga PASH, me vlerë **20,989,426** lekë.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2019 Shoqëria "C & S Construction Energy" SHPK ka realizuar shpenzime në masën **197,247,693** lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit **68,159,149** lekë ku përfshihen: llogaria 605 "Blerje/shpenzime mallra, shërbimesh", llogaria 608 "Blerje/shpenzime të tjera", llogaria 611 "Trajtime të përgjithshme", llogaria 613 "Qira", llogaria 618 "llogaria 638 "Tatime të tjera", llogaria 657 "Gjoha dhe dëmshpërblime", llogaria " 616 " Sigurime", 6271 "Transporte për blerje" llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore".

Paga në vlerën 12,041,753 lekë ku përfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për **1,920,974** lekë ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore".

Shpenzime konsumi dhe amortizimi në vlerën 86,426,030 leke nga llogaria 6862 "per AQ afatgjate".



Shpenzimet financiare ne vleren 26,119,130 leke përfshijnë:

Llogaria 628 "Sherbime bankare", llogaria 667 " Shpenzime per interesa" , llogarine 658 "Shpenzime te tjera"
llogaria 669 "Humbje nga kembimet valutore"

Shpenzime e tatimit mbi fitimin ne vleren 3,984,517 leke nga llogaria 694 "Tatime mbi fitimet".

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën 222,221,635 lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet:

Llogaria 704 " Shitje e punimeve dhe e sherbimeve" në vlerën 222,221,635 lekë.

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	24,973,942
SHPENZIME TE PANJOHURA	1,589,500
TATIM FITIMI (15%).	3,984,516
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	20,989,426

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim 10,390,392 lekë

Mjete monetare në fund 1,383,789 lekë

Diferenca 9,006,603 l leke

Pra,ka perputhje te plote te pasqyres te fluksit monetar dhe gjendjes te aktiveve monetare te vendosura ne aktiv te bilancit.



PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej 203,420,312 lekë cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2019.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2019.

Tiranë , më 30.03.2020

Ekonomisti

 (ose)

Administratori

Arjan Cukaj


